



Datë: 20.06.2025
Numër Protokolli: 4295/2025

A.nr.687/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.664/2024 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.S, ankesën A.nr.666/2025 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi S.T si dhe ankesën A.nr.687/2025 të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi K.D, kundër organit të punësimit: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.687/2025, e datës 22.04.2025, e parashtruar nga ankuesi A.S, ankuesi S.T si dhe ankuesi K.D.
- II. **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit me Numër Reference: RN00016306, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- III. **Obligohet** U.D Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit, A.S, S.T dhe K.D (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesit), më datë 16.04.2025, respektivisht më datë 22.04.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016306, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.04.2025, 28.04.2025 dhe 30.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ndërsa kjo e fundit më datë 05.05.2025, 06.05.2025 dhe 07.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3288/2025, të datës 20.05.2025, ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.664/2024 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.S, ankesën A.nr.666/2025 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi S.T si dhe ankesën A.nr.687/2025 të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesi K.D.

Ndërsa, Kryetari I Këshillit pas pranimit të kërkesës së Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, përmes Vendimit VK/2025 dhe numër protokolli 3784/2025, të datës 04.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.687/2025 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2512/2025 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.S në Këshill; Dokument identifikimi i ankuesit; Njoftimi me numër protokolli i datës 21.03.2025; Vendimin me numër protokolli 648 të datës 28.02.2025; Diplomën e datës 29.08.2019; Kontratën e punës të datës 31.12.2018; Dëshmitë mbi vlerësimin e performancës të datës 27.12.2024 dhe 26.12.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 05.05.2025; Konkursin me numër reference RN00016306, për pozitën e “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale; Njoftimin me numër protokolli 647 të datës 28.02.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 21.03.2025; Shpalljen publike për pranimin e ekspertit të jashtëm; Vendimin me numër protokolli 05-1429 të datës 27.02.2025; Vendimin me Nr.03/252 të datës 13.03.2025; Vendimin me Nr.05/251 të datës 12.03.2025; Akt emërimit me numër protokolli 05-9186 të datës 25.11.2024; Vendimin 13/151 të datës 12.07.2023; Vendimin me numër protokolli 1520 të datës 12.04.2024; E-mailin e datës 04.04.2024; Vendimin me Nr.14/52 të datës 29.12.2021; Vendimin me Nr.08/130 të datës 22.03.2023; Testet me shkrim; Aplikacionin e ankuesit A.S, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 12.02.2025; Aplikacionin e kandidatit A.G, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 13.02.2025; Aplikacionin e kandidatit D.B, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 13.02.2025; Aplikacionin e kandidatës G.S, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 12.02.2025; Aplikacionin e kandidatit G.K, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 21.01.2025; Aplikacionin e kandidatit H.Sh, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 11.02.2025; Aplikacionin e ankuesit K.D, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 13.02.2025; Aplikacionin e kandidatës L.H, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 31.01.2025; Aplikacionin e kandidatit M.M, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 10.02.2025; Aplikacionin e kandidatës N.Ll, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 11.02.2025; Aplikacionin e kandidatit R.B, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 13.02.2025; Aplikacionin e kandidatës R.O, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 22.01.2025; Aplikacionin e ankuesit S.T, së bashku me

dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 20.01.2025; Aplikacionin e kandidates S.H, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 06.02.2025; Aplikacionin e kandidates V.K, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 07.02.2025; Aplikacionin e kandidatit Xh.D, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 18.01.2025; Aplikacionin e kandidates Y.K, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës me datë 18.01.2025; Ankesën me numër protokolli 2515/2025 të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesi S.T në Këshill; Dokument identifikimi i ankuesit; Provat e bashkangjitura nga ankuesi me datë 12.05.2025 dhe datë 19.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 06.05.2025; Ankesën me numër protokolli 2606/2025 të datës 22.04.2024, të parashtruar nga ankuesit K.D në Këshill; Dokument identifikimi i ankuesit; Vendimin me numër protokolli 650 të datës 28.02.2025; Plotësim i ankesës së datës 02.05.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 07.05.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me datë 14.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016306, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me afat aplikimi nga data 15.01.2025 deri më datë 13.02.2025, ku sipas sipas pikës 3 të këtij konkursi, kërkesa të përgjithshme formale, kanë qenë këto:

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në drejtimet: Fakulteti i Farmacisë, Ekonomikut, Juridikut, Kimisë, Mjekësisë, Biologjisë, Fizikës.
- **b) Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- **c) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë:
 - c.1.) pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose
 - c.2.) katër (4) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose
 - c.3.) tre (3) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) kandidatë, ku prej tyre nëntë (9) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesin S.T, cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit duke arritur gjithsejtë 81 pikë nga kjo procedurë rekrutimi.

Ndërsa, ankuesit A.S, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, përmes Vendimit me numër protokolli 648 të datës 28.02.2025, i ka refuzuar aplikacionin e punësimit me arsyetimin se nuk posedon përvojën e punës së kërkuar me shpalljen e konkursit, respektivisht përmes Vendimit me numër protokolli 650 të datës 28.02.2024, ankuesit K.D, i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.

Tutje, sipas Njoftimit me numër protokolli 921 të datës 21.03.2025, lidhur me shpalljen e kandidatëve fitues, të Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, rezulton se kandidati H.Sh, me gjithsej 89.6 pikë të arritura, kandidatja L.H me gjithsej 83.8 pikë të arritura, ankuesi me gjithsej 81 pikë të arritura si dhe kandidatja S.H me gjithsej 72.4 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur kandidatë si kandidat fitues për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Ankuesi A.S, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi mbi refuzimin e aplikacionit të tij është nxjerrë përmes vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve të Ligjit Nr.08/ /L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj i njëjti kërkon anulimin e procedurës përkatëse të rekrutimit. Ndërsa ankuesi S.T, pretendon se njëra nga kandidatet fituese nuk posedon 4 vite përvojë punë në pozita drejtuese, ndaj kërkon kthimin e konkursit në fazën e verifikimit paraprak, ashtu siç kërkon edhe ankuesi K.D, i cili ka parashtruar ankesë në Këshill, kundër vendimit mbi refuzimin e aplikacionit të tij.

Rrjedhimisht, bazuar në kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës dhe të pasqyruara si më sipër, Kolegji i Këshillit, ka analizuar aplikacionin e ankuesit K.D, të datës 13.02.2025, nga dhe rezulton se i njëjti ka bashkangjitur Diplomën me Nr.128/14, të lëshuar me datë 02.09.2014, nga Universiteti i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”, me të cilën dëshmohet se i njëjti me datë 30.12.2013, ka mbaruar studimet themelore universitare në Fakultetin e Farmacisë, duke fituar kështu titullin Magjistër i Farmacisë, nga rrjedh se i njëjti ka plotësuar kriterin arsimor. Ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës kandidati në fjalë ka bashkangjitur Kontratën e punës të lëshuar nga N.T.P “METRO-A”, të mbështetur me Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, përmes së cilave dëshmohet se i njëjti nga data 01.01.2014 deri më 31.12.2019, ka qenë i angazhuar në pozitën e *Menaxherit të Përgjithshëm* tek ky punëdhënësi sektorit privat, si dhe po ashtu i njëjti ka bashkangjitur edhe Vendimin me numër protokolli 2880 të datës 08.04.2021, të lëshuar nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes së cilit akt vërtetohet se i njëjti është emëruar *Këshilltar Politik* i Ministres, duke filluar nga data 23.03.2021 e deri në ditën e mbarimit të mandatit, nga rrjedh se ankuesi K.D, ka plotësuar kriteret e konkursit sepse i njëjti posedon përvojë pune profesionale dhe menaxheriale të dëshmuar me prova materiale, siç edhe është kërkuar në konkursin e datës 14.01.2025. Tutje, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i aplikacionit të datës 06.02.2025, të kandidatës S.H, konstaton se e njëjta me anë të dëshmive të bashkangjitura nuk dëshmon se posedon përvojë drejtuese apo menaxheriale, sepse Vërtetimi i lëshuar nga TLD”Sh.P.K” (pa datë lëshimi) në të cilën theksohet se e njëjta është bashkëpronare dhe Drejtore Menaxhuese e kompanisë, nuk gjene mbështetje në Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional, apo nuk rezulton asnjë kontribut i paguar ashtu siç është kërkuar me shpalljen e konkursit të datës 14.01.2025 për punën në sektorin privat, sikurse për Vërtetimin e lëshuar nga “Reis Pharm-A” (pa datë lëshimi), ku theksohet se e njëjta nga data 01.03.2011 deri më 01.07.2017, ka punuar në pozitën e Menaxheres së Barnatores, Kolegji i Këshillit, konstaton se kësaj dëshmie pa mbështetjen e Kontratës për themelimin e marrëdhënies së punës tek ky punëdhënësi dhe në këtë pozitë, është i mangët dhe nuk plotëson kërkesat për t’ia falur besimin, nga rrjedh se e njëjta nuk ka plotësuar njërin nga kërkesat e përgjithshme formale për pjesëmarrje në vlerësimin e kandidatëve për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor Ekzekutiv”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ngase nuk ka dëshmuar me prova bindëse se posedon përvojë drejtuese apo menaxheriale.

Ndërsa, ndërlidhur me provat e bashkangjitura nga ankuesi S.T, më datë 19.05.2025, gjegjësisht: Kontratën e punës të datës 29.06.2011, të lidhur me “Reis Pharm-A” dhe kandidatës S.H; Aplikacionin për licencim si qarkullues farmaceutik me pakicë (barnatore), të datës 07.03.2013, nga Barnatorja “Reis Pharm-A” tek Agjencioni i Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale; Licencën e punës të

kandidates S.H me Nr.KO-12945-05-4, të datës së lëshimit 27.02.2008;, Kolegji i Këshillit, nga shkresat e bashkangjitura nga i njëjti ankues nuk ka gjetur ndonjë shkresë se i njëjti ka vepruar në pajtim me Ligjin NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, gjegjësisht ndonjë kërkesë për qasje në këto dokumente apo vendim mbi bazën e të cilit, i njëjti i ka siguruar këto dëshmi të sa po theksuara të cilat i ka bashkangjitura në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.*

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi K.D me dëshmitë e bashkangjitura me rastin e aplikimit në konkursin përkatës ka vërtetuar se plotëson kërkesat e përgjithshme formale, dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, si njësi përgjegjëse në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidateve që plotësojnë dhe nuk plotësojnë kriteret e konkursit, rrjedhimisht me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit dhe futjen në listë të ngushtë të kandidates S.H, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike si dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në njërin rast ka përfshirë kandidatë që nuk plotësojnë kriteret, ndërsa në rastin tjetër nuk ka përfshirë në listë të ngushtë kandidatë të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 44 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.*., dhe si rrjedhojë e kësaj ka bërë që procedura e rekrutimit, të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016306, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*”, i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.687/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesve: A.S, S.T dhe K.D;
- U.D Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.